

VENDIM
Nr.30, datë 16.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.02.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.1 Akti, që i përket:

KËRKUES: Besim Ziri, Petrit Ziri

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Përmbartimore Krujë, Zyra Përmbartimore Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë, komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë, pranë prefektit të qarkut Durrës.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi për të në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit Besim Ziri dhe Petrit Ziri janë banorë të qytetit të Fushë-Krujës. Në bazë të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, secili prej tyre është pajisur me tokë bujqësore. Për këtë qëllim, Komisioni i Ndarjes së Tokës (KNT) pranë bashkisë Fushë-Krujë ka lëshuar fillimisht formularin nr.6 ku evidentohet numri kadastral i parcelës, sipërfaqja e saj dhe emri i personit që e merr në pronësi. Sipas këtij formulari kërkuesit janë pajisur, përkatësisht, kërkuesi Besim Ziri me parcelën nr.88/2 dhe kërkuesi Petrit Ziri me parcelën nr.88/1. Më pas KNT-ja Krujë ka lëshuar edhe aktet e marrjes së tokës në pronësi në të cilat pasuritë që u janë dhënë kërkuesve rezultojnë të korrigjuara, dhe pra të ndryshme nga ato që pasqyrohen në formularin nr.6. Më konkretisht, sipas akteve bashkëlidhur kërkesës, parcela që i ishte njohur kërkuesit Besim Ziri rezulton e korrigjuar (e fshirë) kurse kërkuesit Petrit Ziri i është njohur në pronësi parcela nr.88/2.

2. Në vitin 2001, kërkuesit i janë drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Krujë për t’u pajisur me vërtetim pronësie, por ky vërtetim nuk u është lëshuar pasi pasuritë përkatëse rezultonin të regjistruara në emër të personave të tretë.

3. Kërkuesit i janë drejtuar KNT-së Krujë me kërkesë për lëshimin e një kopjeje zyrtare të aktit të marrjes së tokës në pronësi, kërkesë e cila u është refuzuar.

4. Në këto kushte, kërkuesit i janë drejtuar gjykatës me padi të veçanta, me objekt detyrimin e KNT-së pranë Bashkisë Fushë-Krujë t’i pajisë ata me aktin e marrjes së tokës në pronësi, sipas formularit nr.6.

5. Me vendimet nr.558, datë 08.10.2008 dhe nr.559, datë 08.10.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur pranimin e kërkesëpadive dhe detyrimin e palës së paditur KNT-së pranë bashkisë Fushë-Krujë të pajisë kërkuarit me aktin e marrjes së tokës në pronësi sipas formularit nr.6. Këto vendime kanë marrë formë të prerë.

6. Me vendimet nr.91, datë 03.05.2010 dhe nr.92, datë 03.05.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka lëshuar urdhrat e ekzekutimit të vendimeve të mësipërme të formës së prerë.

7. Me shkresën e datës 18.05.2010, Zyra Përmbartimore Krujë i është drejtuar KNT-së pranë bashkisë Krujë për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave.

8. Me vendimin e datës 04.06.2010, çështja përmbartimore i është transferuar, për kompetencë territoriale, Zyrës Përmbartimore Durrës, për arsye se me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, kompetencat e KNT-së pranë bashkisë Fushë-Krujë i kanë kaluar Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Durrës.

9. Me shkresën e datës 17.06.2010, Zyra Përmbartimore Durrës i është drejtuar KV-së pranë Prefektit të Qarkut Durrës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

10. Me shkresën e datës 13.07.2010, KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës i është përgjigjur Zyrës Përmbartimore Durrës se, bazuar në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, dhe VKM nr.224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve, të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë”, autorizimi për lëshimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi jepet pasi është krijuar dokumentacioni i ri, ku parashikohet edhe dokumentacioni që duhet të paraqesin qytetarët dhe informacioni që merr KV-ja nga institucionet përkatëse. Në këto kushte, sipas subjektit të interesuar, ekzekutimi nuk mund të bëhet brenda afatit 10 ditor të caktuar nga Zyra Përmbartimore, pasi vendimi merret vetëm pasi të përfundojë procedura e administrimit të dokumentacionit të ri.

11. Me shkresën e datës 30.12.2010, nga ZVRPP-ja Krujë i është dërguar KV-së pranë Prefektit të Qarkut Durrës informacioni lidhur me pasuritë e shtetasve Refat Dervina dhe Ibrahim Dervina, që i referohen pasurive të marra në pronësi nga kërkuarit me formularin nr.6.

12. Me shkresën e datës 07.10.2011, Zyra Përmbartimore Durrës i është drejtuar përsëri KV-së pranë Prefektit të Qarkut Durrës, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe pajisjen e kërkuarve me aktin e marrjes së tokës në pronësi sipas formularit nr.6, duke e informuar subjektin, gjithashtu, se kanë kaluar afatet ligjore dhe se në rast të mosekzekutimit do të aplikohen sanksione me gjobë, si dhe kallëzim për ndjekje penale ndaj personave përgjegjës.

13. Me shkresën e datës 11.10.2011, Prefekti i Qarkut Durrës i përgjigjet Zyrës Përmbartimore, se KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës momentalisht nuk mund të kryejë veprime e të marrë vendime për shkak të pezullimit të funksionimit, bazuar në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008.

14. Me dy kërkesa të veçanta të datës 21.11.2011, kërkuarit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në mënyrë të përmbledhur, ata parashitrojnë se:

14.1 Organet administrative, edhe pse kanë detyrimin kushtetues për të vepruar në përputhje me parimin e ligjshmërisë, të barazisë dhe të proporcionalitetit, dhe çka është më e rëndësishme t’i binden kontrollit të ushtruar nga organet gjyqësore, përsëri nuk kanë lëshuar aktet e urdhëruara nga gjykata.

14.2 Administrata publike nuk është një debitor i zakonshëm, i cili duhet patjetër të presë daljen e urdhrat të ekzekutimit për të përmbushur detyrimet e saj kushtetuese.

14.3 Në rastin konkret, jemi para detyrimit të një organi administrativ për të lëshuar një vërtetim dhe, në këto kushte, ky proces nuk mund të konsiderohet as kompleks dhe as i jashtëzakonshëm. Nuk ka asnjë shkak të arsyeshëm që të justifikojë një pritje prej 10 vjetësh, ndërkohë që procesi duhej të ishte mbyllur brenda 3 muajve.

14.4 Pas një vendimi gjyqësor, i cili detyron organin administrativ të lëshojë një akt administrativ me parametra të caktuar, organi zhvishet nga çdo lloj pushteti diskrecional dhe është i detyruar të zbatojë në mënyrë të përpiktë vendimin gjyqësor. Edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga nxjerrja e urdhrat të

ekzekutimit, përsëri organi administrativ nuk ka përmbushur detyrat e veta ligjore dhe kushtetuese.

15. Gjykata, në mbështetje të nenit 1, pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, meqenëse kërkesat kanë lidhje dhe objekti është i njëjtë, vendosi bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme.

16. **Subjekti i interesuar, KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës**, me shkresën nr.prot 9/1, datë 25.01.2012, parashtron para Gjykatës se:

16.1 Në bazë të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, ky subjekt nuk ka kompetencë të pajisë me titull pronësie asnjë shtetas, por vetëm të verifikojë ligjshmërinë e titujve të pronësisë të dhënë nga ish-komisionet e ndarjes së tokës.

16.2 KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës filloi procesin e verifikimit të titujve të pronësisë, për parcelat objekt konflikti, menjëherë pasi kërkesit aplikuan pranë kësaj zyre me kërkesat nr.298 dhe nr.299, të datës 18.12.2008. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se parcela nr.88/2 është një nga parcelat përbërëse të aktit të marrjes së tokës në pronësi në emër të kërkesit Petrit Ziri, pra ky shtetas e ka titullin e pronësisë për këtë parcelë, por ZVRPP-ja Krujë e ka regjistruar atë në emër të shtetasit Ibrahim Dervina. Në lidhje me parcelën nr.88/1, që pretendohet nga kërkesi Besim Ziri, ajo rezulton e regjistruar në emër të shtetasit Refat Dervina.

16.3 KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës ka kërkuar nga ZVVRP-ja Krujë informacion në lidhje me dokumentacionin e paraqitur për regjistrimin e këtyre pasurive nga shtetasit Dervina. Pasi të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm, në bazë të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, ky komision merr vendimin përkatës për ligjshmërinë e këtyre titujve të pronësisë dhe vendimin për paligjshmërinë e titullit të pronësisë e dërgon në gjykatë, për anulimin e tij. Pavarësisht sa më sipër, komisionet vendore nuk mund të marrin vendime në këtë periudhë, pasi ligji nr.9948, datë 07.07.2008, ka pushuar së vepruari që nga muaji gusht 2011, dhe janë në pritje të shtyrjes së këtij afati.

II

A. Lidhur me pretendimin për mosekzekutimin, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

17. Gjykata ka interpretuar në jurisprudencën e saj parimin e shtetit të së drejtës i cili, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete edhe detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Zbatimi i plotë dhe efektiv i vendimeve gjyqësore është me rëndësi thelbësore për shtetin, me qëllim që të krijojë, forcojë dhe zhvillojë një sistem gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë (*shih vendimet nr.8, datë 23.03.2010; nr.13, datë 22.04.2011; nr.13, datë 21.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë përbën një element të rëndësishëm të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Në opinionin e Gjykatës, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar mbetet pa asnjë vlerë nëse nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit (*shih vendimin nr.6, datë 31.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr.49, datë 21.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Parimet lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe detyrimin për ekzekutimin e vendimeve

gjyqësore, janë të një rëndësie akoma më të madhe në kontekstin e procedurave administrative që kanë të bëjnë me një mosmarrëveshje, rezultati i të cilës është vendimtar për të drejtat civile të kërkuarit. Mbrojtja efektive e një pale në procedura të tilla dhe rikthimi i ligjshmërisë nënkupton një detyrim për autoritetet administrative të zbatojnë vendimet e gjykatës. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se autoritetet administrative përbëjnë një element të shtetit të së drejtës dhe, si pasojë, interesat e tyre përputhen me nevojat për administrimin e mirë të drejtësisë (*shih vendimin nr.6, datë 07.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuarit dhe sjelljen e autoriteteve publike.

i) *Lidhur me kompleksitetin e çështjes.*

21. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Gjykata vëren se çështja objekt gjykimi nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike. Për sa i përket ligjit të zbatueshëm, rezulton se në vitin 2008 ka hyrë në fuqi ligji nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i cili në nenin 17, pika 2, parashikon, mes të tjerash, se në datën e hyrjes në fuqi të tij, komisionet e tokës, të krijuara në bazë të nenit 7 të ligjit nr.7501 “Për tokën”, mbarojnë funksionimin dhe veprimtarinë e tyre për ndarjen e tokës dhe ato e dorëzojnë të gjithë dokumentacionin ekzistues të ndarjes së tokës në seksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës (SAMT) në qark. Në pikën 3 të këtij neni parashikohet, gjithashtu, se : “*Të gjitha ankesat dhe kërkesat me shkrim të personave fizikë dhe juridikë, që janë bërë dhe regjistruar pranë komisioneve të tokës së komunave dhe/ose bashkive dhe komisioneve të tokës së këshillave të qarqeve, për të cilat nuk janë përfunduar procedurat e shqyrtimit dhe të marrjes së vendimeve përkatëse, i kalojnë KV-së me procesverbal brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*” Në bazë të nenit 8 të këtij ligji, KV-ja ka detyrë dhe përgjegjësi, mes të tjerash, edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të evidentuara ndërmjet individëve dhe ish-komisioneve të tokës së fshatit. Në bazë të këtij ligji, kompetencat e KNT-së pranë bashkisë Krujë i kanë kaluar KV-së pranë bashkisë Durrës dhe në kushtet kur është parashikuar edhe organi i ngarkuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pazgjidhura mes individëve dhe ish-komisioneve të tokës, Gjykata vlerëson se kjo çështje nuk paraqet kompleksitet as nga pikëpamja e ligjit të zbatueshëm.

ii) *Lidhur me sjelljen e kërkuarve*

22. Bazuar në nenin 511 të KPC-së, titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesë të kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit. Neni 515 i KPC-së parashikon se urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbartuesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit. Në lidhje me sjelljen (veprimet) e kërkuarve, rezulton se ata kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale. Fillimisht ata i janë drejtuar KNT-së Krujë për pajisjen me aktin e marrjes së tokës në pronësi. Duke qenë se kanë hasur në refuzimin e kësaj të fundit, ata i janë drejtuar gjykatës dhe pasi janë pajisur me vendimet gjyqësore të formës së prerë, të ekzekutueshëm, në favor të tyre, i janë drejtuar organit të ngarkuar nga ligji për këtë qëllim, për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

iii) *Lidhur me sjelljen e autoriteteve publike*

23. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër, vazhdimisht, detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr.43, datë më 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse duhet të mbrohen efektivisht të drejtat dhe të respektohet shteti i së drejtës, autoritetet administrative janë të detyruara, rrjedhimisht, të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t’i ekzekutojnë këto vendime, garancitë, që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor, e humbasin qëllimin e tyre (*shih vendimin nr.8, datë 23.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar gjithashtu se një vonesë në ekzekutimin e një

vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (shih vendimet nr.6, datë 06.03.2009; nr.43, datë 19.12.2007; nr.8, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

24. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e secilit prej tyre. Për sa i përket veprimeve të Zyrës Përmbartimore, Gjykata vlerëson se ato kanë qenë formale. Edhe pse ajo i ka dërguar disa shkresa debitorit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nuk rezulton që të ketë marrë ndonjë masë tjetër ligjore, siç është vendosja e sanksioneve apo dhe kallëzimi penal për pengim të ekzekutimit.

25. Në lidhje me sjelljen e debitorit, rezulton se KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës pretendon se autorizimi për lëshimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi jepet pasi është krijuar dokumentacioni i ri për titullin e pronësisë dhe se vendimi merret vetëm pasi të përfundojë procedura e administrimit të dokumentacionit të ri. Madje debitori justifikohet edhe me faktin se bazuar në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008, këto komisione kanë pushuar së vepruari që nga muaji gusht 2011 dhe ato janë në pritje të shtyrjes së këtij afati.

26. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 18 të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, duhej të përfundonte brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes së tij në fuqi, pra deri në gusht 2011. Nga korrespondenca, bashkëlidhur kërkesës, midis debitorit dhe Zyrës Përmbartimore Durrës apo dhe institucioneve të tjera, si Ministria e Drejtësisë, rezulton se debitori ka kërkuar informacion nga ZVRPP-ja Krujë lidhur me dokumentacionin e regjistrimit të këtyre pasurive në pronësi të shtetasve Dervina, me qëllim të verifikimit të titujve të pronësisë të këtyre të fundit. Ndërkohë që, referuar vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kërkimet e kërkuësve dhe disponimet e gjykatës lidhen me pajisjen e tyre me aktin e marrjes së tokës në pronësi, sipas formularit nr.6, një dokument ekzistues i lëshuar që në vitin 1991 nga KNT-ja pranë bashkisë Krujë dhe që, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, së bashku me të gjithë dokumentacionin ekzistues të ndarjes së tokës, i është dorëzuar SAMT-së në qark. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se verifikimi i titujve të pronësisë, bazuar në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008, është një procedurë e ndryshme nga konflikti në fjalë dhe, si e tillë, nuk e pengonte debitorin të ekzekutonte vendimet gjyqësore të formës së prerë. Për më tepër Gjykata vëren se debitori, në parashtrimet me shkrim drejtuar kësaj Gjykate ka pretenduar se ai nuk ka kompetencë të pajisë individët me tituj pronësie, por vetëm të verifikojë ligjshmërinë e titujve të pronësisë, por nuk rezulton që ai ta ketë ngritur më parë këtë pretendim apo dhe të ketë shfrytëzuar ndonjë nga mjetet ligjore në fuqi për kundërshtimin në rrugë gjyqësore të procedurave të vëna në lëvizje nga përmbartuesi gjyqësor.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se organet shtetërore, nëpërmjet sjelljes së tyre, kanë cenuar të drejtën e kërkuësit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke konstatuar cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Petrit Plloçi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha